



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 45 prot.

Kamëz, më 25.6.2025

V E N D I M

Nr. 33 .Datë 25.6 2025

MBI

“MIRATIMIN NË PARIM TË NISJES SË PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E ÇMIMIT TË BILETAVE TË TRANSPORTIT URBAN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.06.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.33 Datë 18.06.2025 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimit të licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar; Vendimin nr. 85, datë 08.02.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me biletat e transportit rrugor” (i ndryshuar); Udhëzimit nr. 3743, datë 10.07.2017 “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve” (i ndryshuar); Urdhrit nr. 215, datë 27.02.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës së shoqatës së transportit urban dhe interurban” (i ndryshuar), si dhe shkresës nr. 1242 prot., datë 04.02.2025, ardhur nga shoqëria Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të nisjes së procedurave përkatëse për rishikimin e çmimit të biletave të transportit urban.
2. Për zbatim ngarkohet Drejtoria e Transportit dhe Licensave; Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit si dhe grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 215, datë 27.02.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës së shoqatës së transportit urban dhe interurban”(i ndryshuar).
3. Ky vendim hyn në fuqi pas ~~konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.~~

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

